

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për Policinë e Burgjeve”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Drejtësisë
FAZAE POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Konsultim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Jo e zbatueshme
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Plani Kombëtar i Integritetit 2017-2021 Programi i Qeverisë Shqiptare 2017-2021, pika 3.1 Shteti Ligjor dhe Drejtësia e Re
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	11.03.2019
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	20.02.2019
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	04.03.2019
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2019 – MD - 0
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Bardhul Kaçori Bardhul.Kacori@dpbsh.gov.al Klobeta Zylyfi Klobeta.Zylyfi@drejtesia.gov.al

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky projekt akt propozohet në përputhje me problematikat e konstatuara nga institucionet dhe organizatat joqeveritare si dhe me programin politik të Këshillit të Ministrave, që parashikon se: *Qeveria do të hartojë dhe zbatojë një reformë rrënjësore në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimeve penale*. Reformimi në tërësi i sistemit të burgjeve dhe forcimi i masave të kontrollit për të garantuar sigurinë në burgje, është kryefjalë e reformave të ndërmarra nga Ministria e Drejtësisë.

Në kuadër të angazhimit të qeverisë shqiptare për reformimin e sistemit të drejtësisë, ku sipas Programit të Qeverisë Shqiptare 2017-2021, pika 3.1 Shteti Ligjor dhe Drejtësia e Re, pjesë e rëndësishme e këtij procesi reformimi do të jenë edhe institucionet penitenciare, burgjet dhe paraburgimet, si dhe shërbimi i provës, me qëllim rritjen në mënyrë efektive të veprimtarisë së këtyre institucioneve ligjzbatuese në ekzekutimin e vendimeve penale.

Ligji i Policisë së Burgjeve, është miratuar fillimisht në Prill 1998. Si rezultat i problematikave të dala ishte e nevojshme miratimi i një ligji të ri në vitin 2008, ligj i cili i'u nënshtrua ndryshimeve në vitin 2014.

Qëllimi kryesor i projektligjit “Për policinë e burgjeve”, konsiston në:

- krijimin e një stafi me kapacitete të mjaftueshme profesionale, të motivuar dhe me integritet, të aftë për të garantuar sigurinë në burgje dhe paraburgime;
- përmirësimin e gjendjes ekonomike financiare dhe kushteve të punës të punonjësve të Policisë së Burgjeve, në raport të drejtë me punonjësit e agjencive të tjera të përafërta në status dhe ecuri në karrierë;
- përmirësimin e procedurave të rekrutimit, trajnimit dhe promovimit në detyrë të punonjësve të policisë së burgjeve.
- garantimin e rotacionit të vazhduar brenda sistemit, me qëllim motivimin dhe shmangien e konsumit profesional, të stresit dhe frustrimit të punonjësve;

- respektimin e të drejtave të punonjësve duke siguruar mbështetje edhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

Gjithashtu, qëllim tjetër i këtij projektligji, është edhe zbatimi i masave të parashikuara për ministrinë e Drejtësisë, sipas vendimit nr. 246, datë 09.05.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2018-2020”. Në këtë plan është parashikuar që ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të vazhdojnë reformimin e sistemit të burgjeve me qëllim garantimin e sistemit të menaxhimit të sigurisë të burgjeve në përputhje me standardet e BE-së nëpërmjet forcimit të kapacitetit të policisë së burgjeve.

Qëllimi i ligjit do të përmbushet nëpërmjet përmirësimit të akteve nënligjore për Sistemin e Burgjeve si edhe duke përmirësuar statusin e punonjësve, organizimin strukturor dhe organizativ të Sistemit të Burgjeve.

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja qeverisë?

Problemi në shqyrtim

Përmes këtij propozimi, synohet t’i jepet zgjidhje ligjore një problemi me të cilin është ndeshur në praktikë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve lidhur me forcimin e masave të kontrollit për të garantuar sigurinë në burgje dhe nga ana tjetër krijimin e stafi profesional dhe të motivuar.

Problematikat e konstatuara gjatë zhvillimit të veprimtarisë së këtij institucioni, në masat e kontrollit për të garantuar sigurinë në burgje në vendin tonë, qoftë në aspektin teorik apo praktik, si dhe ndryshimet që ka pësuar legjislacioni penal, kanë diktuar nevojën për ndërmarrjen e masave të reja me qëllim rikonceptimin dhe forcimin e masave të kontrollit.

Realizimi i misionit dhe vizionit të sistemit të zbatimit të vendimeve penale me burgim, si pjesë e rëndësishme e sistemit të drejtësisë penale, mbështetet para së gjithash në integritetin, gatishmërinë, motivimin dhe kapacitetet profesionale të stafit.

Me gjithë ndryshimet e deritanishme, në praktikë dhe në raportet e vazhdueshme të organizatave të ndryshme (Departamenti Amerikan i Shtetit, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Avokati i Popullit etj.), janë hasur problematikat si më poshtë:

- Nuk janë përmirësuar kriteret e kualifikimit, zhvillimi i karrierës dhe promovimi në detyrë i punonjësve të policisë.
- Trajtimi ekonomik dhe financiar si dhe kushtet e punës kanë mbetur në nivele të ulëta në krahasim me agjencitë e tjera të përafërta në status dhe ecuri në karrierë.
- Trajnimi bazë dhe ndjekja e trajnimit të vazhdueshëm i punonjësve të policisë të rolit bazë dhe të mesëm, nuk është i përshtatshëm në lidhje me standartet evropiane dhe kërkesat për përmbushjen e detyrave.
- Kapacitetet profesionale dhe fizike të disa shërbimeve, veçanërisht operacionale janë të ulëta dhe kanë nevojë për përtëritje. Përmirësimi i teknologjisë, kërkon një staf më të kualifikuar, me qëllim garantimin e sigurisë.
- Niveli i performancës së punonjësve të policisë së burgjeve lidhur me respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të të dënuarve dhe të paraburgosurve, garantimin e sigurisë në burgje dhe procesin e rehabilitimit është jo i kënaqshëm.
- Punonjësve nuk i sigurohet mbështetje pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.
- Punonjësve të Policisë së Burgjeve nuk i jepen apo garantohen të drejta të tjera shtesë si rezultat i pamundësisë ekonomike, të tilla si e drejta e mbështetjes në strehim.

- Punonjësve të policisë nuk i garantohet mbrojtje e veçantë kur i kërcënohet jeta, familja dhe prona për shkak të detyrës.
- Nuk realizohet kompensimi i orëve shtesë të punës të kryera gjatë pushimit javor, ose në ditët e festave zyrtare.

Shkaqet e problemit

- Menaxhimi i deritanishëm, nuk garanton një balancë, ndërmjet kërkesave për përmirësimin e shërbimit publik dhe respektimit të të drejtave të punonjësve. Ndaj duhet të evidentohen edhe më qartë sfidat me të cilat përballet administrata e burgjeve në menaxhimin e kapaciteteve fizike dhe respektimin e të drejtave të të dënuarve/paraburgosurve.¹
- Shpërndarja e 24 institucione të ekzekutimit të vendimeve penale nga veriu në jug dhe në disa raste shumë larg qendrave urbane, me kapacitete të ndryshme, në të cilët trajtohen persona me rrezikshmëri të lartë për komunitetin dhe rendin publik shkakton probleme infrastrukturore, lodhje fizike për punonjësit si dhe shtim të orarit të punës për shkak të akomodimit. Për më tepër shpërndarja e këtyre institucioneve duke marrë parasysh kapacitetin dhe mbipopullimin e burgjeve e bën të vështirë menaxhimin e situatave pavarësisht sistemimit të personave në konflikt me ligjin referuar shkallës së rrezikshmërisë shoqërore. Si pasojë e mbipopullimit të institucionit dhe problematikave të hasura në institucion, punonjësit e kanë shumë të vështirë të ndërmarrin masat e kontrollit për të garantuar sigurinë në burgje. Mungesa e profesionalizimit dhe mbipopullimi kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në mos rehabilitimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve, madje ka shkakur konflikte dhe dhunë në institucion. Referuar raporteve dhe studimeve të mësipërme është vërejtur se këto problematika janë të shtrira në 24 institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Edhe pse krahasuar me vitin 2016 mbipopullimi në burgje është ulur ndjeshëm, gjatë 2017, 2018 dhe fillimit të vitit 2019 mbipopullimi është shënuar si fenomen shqetësues në disa IEVP.² Ky fenomen detyrimisht sjell pasojë në drejtim të reduktimit të kohës së ajrimit, kohës së takimit me të afërmit, të trajtimit individual të paraburgosurve nga ana e punonjësve të kujdesit social, ligjor etj.

Në një nga raportet e tij mbi gjendjen e sistemit penitenciar, Avokati i Popullit raportoi se mbipopullimi ka çuar në reduktimin e hapësirave fizike për mbarëvajtjen e aktiviteteve të përbashkëta. Për më tepër, duke u përballuar me një numër më të madh të dënuarish, administrata e burgut vendoset në pamundësi për të përmbushur në mënyrë të kënaqshme kërkesat për hartimin dhe zhvillimin e programeve rehabilituese të individualizuara në përputhje me veçoritë e personalitetit të secilit të burgosur.³

- Rekrutimi i punonjësve: Procedurat aktuale dhe situata në të cilën ndodhen punonjësit e policisë së burgjeve, sjell vështirësi në rekrutimin e punonjësve cilësor dhe prezencën e një numri të konsiderueshëm të punonjësve me moshë mbi 55 vjeç, gjë që sjell vështirësi në kryerjen e detyrave që kanë lodhje fizike. Numri i punonjësve të policisë së burgjeve, mbi 50 vjeç është 24.7 %. Lidhur me këtë element duhet të parashikohen kriteret për pranimin në Policinë e Burgjeve. Punonjësi duhet të ketë kushte shëndetësore dhe fizike që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse. Të parashikohet një kriter që lidhet me moshën, ku të drejtë të

¹ <https://www.osce.org/sq/albania/246866>

² <http://www.dpbsh.gov.al/skedaret/1534939984-Analiza%20vjetore-%20DPB-2017.docx>.

³ <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/nees/institucioni-i-avokatit-te-popullit-nxjerr-rekomandim-per-respektimin-e-te-drejtave-ligjore-te-punonjesve-te-policise-se-burgjeve-105/>

konkurrojë për t'u pranuar në Policinë e Burgjeve të ketë çdo person nën moshën 35 vjeç. Pranimi në polici duhet të bëhet duke vlerësuar aftësitë fizike, në momentin e pranimi duhet të kryhet trajnimi bazë i Policisë së Burgjeve dhe më pas të ndiqet trajnimi vazhdues. Raportet e organizatave të ndryshme kanë theksuar se aktualisht marrëdhëniet e punës në Policinë e Burgjeve nuk bazohen në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale, mosdiskriminimit apo respektimin e një procesi transparent e të drejtë.

- Punonjësit e policisë përballen me kushtet e vështira të punës, trajtimin ekonomik dhe financiar, mungesën e mbështetjes pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës dhe mostrajnimi sipas standarteve evropiane.
- Grupet e prekura nga ky problem janë punonjësit e policisë së burgjeve, të dënuarit apo të paraburgosurit, vizitorët, administrata shtetërore dhe qytetarët.
- Ligji i Policisë së Burgjeve, është miratuar fillimisht në Prill 1998 dhe më pas është ndryshuar në vitin 2008 dhe në vitin 2014, në të janë të parashikuara të gjitha kriteret e kualifikimit, trajtimit ekonomik dhe financiar, trajnimit bazë dhe të vazhdueshëm. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve janë marrë të gjitha masat për programin dhe manualin e trajnimit të punonjësve. Pavarësisht këtyre parashikimeve ligjore dhe programeve të trajnimit të hartuara dhe të vëna në zbatim nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në mënyrë të vazhdueshme, vihet re që problematikat janë aktuale. Sa më sipër, ndërhyrja e qeverisë vlerësohet e domosdoshme për rregullimin me ligj të këtyre problematikave, duke marrë parasysh edhe objektivat e Strategjisë së Reformës në Drejtësi dhe PKIE (Plani Kombëtar i Integritetit Europian). Ndryshimi i ligjit aktual nuk mund të arrijë objektivat e vendosura, duke qenë se duhet të ndryshohet më shumë se 70 përqind e ligjit aktual, pavarësisht se do të ketë më shumë kosto në burime dhe në kohë.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivat kryesorë që synohen të arrihen janë:

- Të krijohet një staf me kapacitete të mjaftueshme profesionale duke i'u nënshtruar trajnimit bazë dhe të vazhdueshëm, i motivuar dhe me integritet, i aftë për të garantuar respektimin e masave të kontrollit, rendin dhe sigurinë në institucionet e ekzekutimeve penale dhe gjatë transferimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve.
- Të përmirësohet gjendja ekonomike financiare dhe kushteve të punës të punonjësve të policisë së burgjeve, në raport të drejtë me punonjësit e agjencive të tjera të përafërta në status dhe ecuri në karrierë për një afat tre vjeçar.
- Të përmirësohen procedurat e rekrutimit, trajnimit dhe promovimit në detyrë të punonjësve të policisë së burgjeve mbi bazën e procedurave transparente, të paanshme, shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit me qëllim përmirësimin e shërbimeve ndaj publikut për një afat tre vjeçar.
- Ti garantohet trajtim financiar pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës, në formën e pagesë kalimtare, pension të parakohshëm suplementar, pension shërbimi, pension suplementar pleqërie, vjetërsi në punë.
- Të kompensohen orët shtesë të punës së kryer gjatë pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare.
- Punonjësit të policisë ti garantohet mbrojtje e veçantë kur i kërcënohet jeta, familja dhe prona për shkak të detyrës.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsioni 0 – status quo-ja

Nëse nuk ndërmerret kjo nismë, problematikat e konstatuara gjatë viteve në shërbimin e policisë, do të mbeten prezente, duke sjellë probleme të sigurisë, të demotivimit të punonjësve, dinamikë të madhe të lirimeve, që shoqërohet edhe me një kosto financiare dhe paqëndrueshmëri të shërbimit.

Nxjerrja e një ligji të ri apo ndryshimi i ligjit ekzistues mund të mos kërkohej me arsyetimin se çështja mund të vetë rregullohet apo rezultatet mund të arrihen me mënyra të tjera jo formale, por për të plotësuar objektivat që synohen të arrihen është e domosdoshme të miratohet një ligj i ri pavarësisht kostove në burime dhe në kohë.

Opsioni 1 (rregullator): – Ndryshimi i ligjit Nr.10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar.

Ndryshimi i ligjit do të kishte një kosto më të ulët në burime dhe në kohë, por do të ulte sigurinë e zbatimit të ligjit, mund të krijojë dyshime mbi stabilitetin e ligjit dhe të lëkundë besimin në të.

Për të zbatuar objektivat që synohen të arrihen është e nevojshme të ndryshohen parimet kryesore të ligjit ekzistues, parimet bazë dhe struktura e tij, ndryshime të cilat arrijnë masën 70 përqind. Këto ndryshime prekin thelbin e ligjit dhe nuk rregullojnë disa aspekte të tij, ndaj duhet të mendohet mbi mundësinë e një ligji të ri.

Në rast se do të vijohej me amendime në ligjin ekzistues, nuk do të arrihej objektivi kryesor për përmirësimin e kushteve të trajtimit financiar të punonjësve dhe për përcaktimin e procedurave të promovimit dhe zhvillimit të karrerës.

Opsioni 2 (rregullator): – Miratimi i një ligji të ri.

Ky projekt akt duhet të propozohet referuar problematikave të shumta të konstatuar nga organizata apo institucione të ndryshme dhe në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave, që parashikon se: *Qeveria do të hartojë dhe zbatojë një reformë rrënjësore në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimeve penale*. Krahas rezultateve pozitive, në garantimin e sigurisë dhe rehabilitimin e personave në konflikt me ligjin, që ka arritur sistemi shqiptar i burgjeve dhe paraburgimeve nga ligji Nr.10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar, vlerësohet se ka disa problematika të cilat duhen përmirësuar duke marrë parasysh edhe objektivat e Strategjisë së Reformës në Drejtësi dhe PKIE (Plani Kombëtar i Integritetit Europian) të cilat nuk mund të arrihen duke ndryshuar ligjin aktual. Miratimi i një ligji të ri është opsioni i preferuar pavarësisht se do të ndikojë në ekonomi si kosto në buxhetin e shtetit. Miratimi është i domosdoshëm për të arritur objektivat e vendosura, në raport dhe me llogaritjen e përfitimeve në buxhetin e shtetit apo ndikimet sociale.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet ekonomike:

Kosto në buxhetin e shtetit: Fondet e nevojshme për përmirësimin e pagesave të stafit të policisë së burgjeve, për arsye të rrezikshmërisë, vështirësisë dhe rëndësisë së shërbimit, mbështetje për lehtësimin e transportit të punonjësve të cilët punojnë në IEVP, larg

qendrave urbane. Përmirësim i pajisjeve të policisë së burgjeve. Trajtimi i familjarëve të punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës. Trajtimi financiar pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Kompensim i interesave të kredisë në një përqindje të caktuar.

Përfitimet në buxhetin e shtetit: Ulje të numrit të punonjësve që lirohen dhe përfitojnë pagë kalimtare. Reduktim të shpenzimeve në përdorimin e pajisjeve, uniformave dhe mjeteve të tjera. Ulje të kostos së trajnimeve.

Nga një analizë e ndikimeve ekonomike si kosto në buxhetin e shtetit dhe si përfitim, konkludojmë se përfitimet në buxhetin e shtetit janë më të mëdha. Këto përfitime nuk lidhen vetëm me anën ekonomike si përfitime në buxhetin e shtetit, por dhe si përfitime sociale. Aktualisht numri i të larguarve nga puna është i lartë, ku ka një rotacion të vazhdueshëm të punonjësve. Me ndërmarrjen e një nisme ligjore, do të bëhej e mundur që të ulej numri i punonjësve që lirohen dhe përfitojnë pagë kalimtare.

Ndikimet sociale:

- Ulje të lirimeve nga puna dhe motivim të punonjësve;
- Rritje të standarteve të shërbimit ndaj personave në konflikt me ligjin;
- Përmirësim i procesit të rehabilitimit dhe riintegrit të të dënuarve dhe paraburgosurve në shoqëri;⁴
- Rritje e ndërgjegjësimit së shoqërisë për rolin e policisë së burgjeve, vështirësitë në kryerjen e detyrës dhe të sigurisë publike;
- Mbështetje më të mirë sociale për familjet e punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës dhe mbrojtje të veçantë fizike në raste rreziku apo situatë emergjente;
- Rritje të besimit ndaj sistemit qeverisës për shkak të përmirësimit të trajtimit ekonomik dhe financiar, kushteve të punës, mbështetjes, trajnimeve dhe gatishmëri më e lartë ndaj detyrave.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni i rekomanduar/i preferuar është:

Opsioni 2.

Avantazhet e opsionit të zgjedhur për përfituesit e drejtpërdrejtë:

- Miratimi i këtij ligji nuk ka një kosto të lartë në buxhetin e shtetit, krahasuar me përfitimet në sigurinë publike, në qëndrueshmërinë e shërbimit, në krijimin e një stafi të trajnuar, me eksperiencë dhe të motivuar për përmbushjen e detyrave.
- Do të balancohet më mirë interesi publik për siguri duke qenë se do të përmirësohen standartet lidhur me sigurinë në burgje dhe respektimi i të drejtave të punonjësve.
- Do të përmirësohet siguria në burgjeve dhe paraburgimeve nëpërmjet forcimit të masave të sigurisë, trajnimit të punonjësve dhe pajisjen me mjete të reja sigurie.
- Miratimi i një ligji të ri do të sjellë impakt pozitiv lidhur me kënaqësinë në punë të punonjësve të policisë duke qenë se do kenë një trajtim financiar më të mirë, do të pajisen me uniforma dhe mjete që do t'i shërbejnë në realizimin e detyrave dhe për rrjedhim një shërbim më të mirë ndaj publikut, siguri dhe shërbim të qëndrueshëm.
- Pajisje më e mirë e punonjësve të policisë së burgjeve me uniforma, mjete,

⁴ <https://www.osce.org/sq/albania/246866>

mbështetje me transport etj. Do të përmirësohen strukturat mbështetëse që shërbejnë për sigurinë në institucionet e vuajtjes së dënimit

- Përmirësimin e gjendjes ekonomike financiare dhe kushteve të punës të punonjësve të Policisë së Burgjeve, në raport të drejtë me punonjësit e agjencive të tjera të përafërta në status dhe ecuri në karrierë.
- Krijimin e një stafi me kapacitete të mjaftueshme profesionale, të motivuar dhe me integritet, të aftë për të garantuar sigurinë në burgje dhe paraburgime.
- Përmirësimin e procedurave të rekrutimit, trajnimit dhe promovimit në detyrë të punonjësve të policisë së burgjeve.
- Respektimin e të drejtave të punonjësve duke siguruar mbështetje edhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.
- Mbrojtje të veçantë fizike në raste rreziku apo situatë emergjente.
- Punonjësve do ti sigurohet mbështetje pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.
- Kompensimi i orëve shtesë të punës të kryera gjatë pushimit javor, ose në ditët e festave zyrtare.

Për përfituesit jo të drejtpërdrejtë miratimi i një ligji të ri do të sjellë:

-Rritje të sigurisë publike.

-Rehabilitim më të shpejtë dhe përmirësim në mënyrën e trajtimit të personave që ndodhen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Vlera monetare e koston dhe e përfitimeve nga ndikimet e mundshme është përcaktuar duke i'u referuar shtesave në pagë të punonjësve të sigurisë, për t'i unifikuar me punonjës të policisë së shtetit, për të njëjtin nivel. Mbështetje për transportin e punonjësve dhe për ushqim. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, duhet të ketë përparësi në trajtimin financiar, ku duhet të përfshihet kompensimi për privacionet që i krijohen punonjësit të policisë së burgjeve për largësi nga vendbanimi, sipas koston së transportit publik dhe trajtimit për ushqim.

Trajtimi financiar pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Mbrojtja e veçantë fizike në raste rreziku apo situatë emergjente.

Kostot e përgjithshme të punonjësve të policisë së burgjeve janë si më poshtë:

- Kosto për pagat: Aktualisht punonjësit e policisë së burgjeve, kanë një pagë deri në 50% më të ulët se punonjësit e policisë së shtetit, megjithëse kryejnë një punë shumë të vështirë, me rrezikshmëri dhe në institucione të mbyllura. Pagat e punonjësve janë të rregulluara me Vendimin Nr. 201, datë 15.3.2017 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të policisë së burgjeve”. Buxheti për pagën është në masën 3.041.793.576 lekë.
- Kosto transporti: Nuk ka kosto për transportin e punonjësve, me Urdhër të ministrit përgjegjës për drejtësinë parashikohet një distancë jo më shumë se 45 Km.
- Kosto për uniforma: Uniforma e një punonjësi, të rolit të mesëm kushton 65000 lekë x 230 punonjës = 14.950.000 lekë. Uniforma e një punonjësi të rolit bazë kushton 60000 lekë x 3220 punonjës =193.200.000. Totali i kostove vetëm për uniforma shkon në 223.100.000 lekë.
- Kosto për trajnime: Kostoja e trajnimit bazë për një punonjës është 780 lekë/ditë, kjo sipas shpenzimit të kryer për trajtimin me ushqim ditor, në ambjentet e akademisë së policisë, pjesa tjetër është si akomodimi, etj janë mbuluar tek institucioni i akademisë së policisë së shtetit. Në total kosto trajnimi, llogariten rreth 15.000.000 lekë (catering, mjete mësimore, udhëtime, dieta etj)

Miratimi i një ligji të ri, duhet të bëhet edhe për të shmangur ndërhyrjet e shpeshta në ligjin ekzistues si dhe duke qenë se ndryshimet e propozuara prekin më shumë se 70% të ligjit ekzistues.

Në tabelën e më poshtme janë llogaritur nevojat për buxhet gjatë tre viteve, për arritjen e objektivave të vendosura.

Periudha kohore	2019	2020	2021
Nevoja për buxhet	1,006,987	1,006,987	1,006,987

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare (kostoja në mijë lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyt pse?)

Nisma është hartuar si rezultat i një konsultimi të vazhdueshëm të anëtarëve të rrjetit RIA, pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Për konstatimin e këtyre problematikave dhe objektivave ky grup pune ka marrë në analizë të gjithë raportet, analizat, studimet etj të institucioneve dhe organiatave të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Si nxitje kanë shërbyer kërkesat dhe ankesat e ndryshme të punonjësve të policisë së burgjeve dhe personave në konflikt me ligjin. Këto nisma synonjë në thelb përafrimin e legjislacionit të burgjeve me standartet evropiane.

Faza e konsultimit për këtë nismë do të zhvillohet nga Ministria e Drejtësisë. Nisma që parashikon miratimin e një ligji të ri “Për policinë e burgjeve”, është publikuar për konsultim publik me qytetarët më datë 11.03.2019. Afati i konsultimit publik është 20 ditë pune. Deri tani nuk ka asnjë koment për këtë nismë. Ndërkohë Ministria e Drejtësisë është duke përgatitur listën e organizatave jofitimprurëse, shoqërisë civile dhe jo vetëm, për të diskutuar në vijim në lidhje me këtë nismë.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Pas hyrjes në fuqi të ligjit, Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Drejtësisë të ngarkohen që të miratojnë aktet nënligjore përkatëse.

Monitorimi dhe vlerësimi i i performancës së policisë së burgjeve do të realizohet në bazë të një plani vjetor të planifikuar të inspektimit nga struktura përkatëse pranë Ministrisë së Drejtësisë. E njëjta metodologji punë do të ndiqet edhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Monitorimi në nivel makro do të realizohet nga struktura përkatëse përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, për monitorimin e institucioneve të varësisë. Gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve do të realizohet monitorimi i zbatimit të detyrave në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore nga ana e punonjësve të degëve territoriale.

Avokati Popullit dhe sindikata e pavarur e punonjesve, do të jenë pjesë e inspektimit të zbatimit të të drejtave të punonjësve, por që kanë pasojë mbi personat që janë në konflikt me ligjin. Punonjësi i Policisë së Burgjeve mban përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e çdo veprimi apo mosveprimi të tij, gjatë ushtrimit të detyrës. Në rastet kur urdhri është i paligjshëm ai nuk duhet ta zbatojë, ndërsa kur urdhri, që konsiderohet i paligjshëm nga urdhërmarrësi, ka të bëjë me trajtimin dhe të drejtat themelore të personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosur, punonjësit e Policisë së Burgjeve, që kanë dijeni për të, kanë detyrimin të njoftojnë krahas strukturave të Ministrisë së Drejtësisë, edhe Avokatin e Popullit. Avokati i Popullit si pjesë e inspektimit dhe mbrojtjes së të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike do të monitorojë këto njoftime që kanë pasojë të drejtpërdrejta në të drejtat e personave në konflikt me ligjin.

Treguesit e monitorimit përfshijnë një sërë treguesish, që përfshijnë të dhëna në lidhje me

numrin e incidenteve, mungesave në punë, shkeljeve disiplinore, ngjarje të rënda lidhur me sigurinë etj.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

- *Jepni kontekstin e politikës*

Ligji i Policisë së Burgjeve është miratuar për herë të parë më 1998, është ndryshuar në 2003. Është miratuar si ligj i ri më 2008, i cili është ndryshuar më 2014. Ndryshimet e herëpashershme, nuk kanë reflektuar nevojat e punonjësve të policisë për mbështetje për shkak të rrezikut, vështirësive dhe rëndësisë së veçantë të shërbimit. Gjithashtu, janë krijuar pengesa të promovimit dhe zhvillimit të karrierës. Probleme të tjera ligji aktual i ka lidhur me kompetencat dhe përgjegjësitë, të cilat nuk janë përcaktuar qartë.

Ekspertët ndërkombëtarë, të cilët kanë marrë pjesë në zbatimin e disa projekteve si Projekti i Binjakëzimit, kanë rekomanduar përmirësime të ligjit aktual, duke u referuar në Rekomandimin 97 (12), mbi trajnimin dhe rekomandimin e stafit të burgjeve. Rekomandimi parashikon që:

- a. Personeli që merret me të burgosurit përballet me vështirësi specifike që paraqesin të burgosurit, atyre duhet t'iu sigurohet trajnim i specializuar i nevojshëm për kryerjen e detyrave të tyre.
- b. Në veçanti, personeli duhet të trajnohet për të pasur plotësisht të qartë nocionin e sigurisë dinamike, me qëllim që ta përdorin këtë qasje ndaj sigurisë gjatë kryerjes së detyrave të tyre.
- c. Personeli i nivelit drejtues, specialist dhe mbikëqyrës duhet të trajnohet, veç të tjerash, edhe si të mbikëqyrë dhe të mbështesë personelin e nivelit bazë në përdorimin e sigurisë dinamike.

Duhet të nxitet lëvizshmëria dhe rotacioni i personelit, për shkak të rritjes së rrezikut të manipulimit të personelit prej të burgosurve afatgjatë.

Duhet të organizohen takime dhe diskutime periodike ndërmjet kategorive të ndryshme të personelit, me qëllim që të arrihet dhe të ruhet ekuilibri ndërmjet mirëkuptimit solidar të problemeve të të burgosurit dhe vendosmërisë në kontroll.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Problematikat e konstatuara gjatë zhvillimit të veprimtarisë së këtij institucioni, në masat e kontrollit për të garantuar sigurinë në burgje në vendin tonë, qoftë në aspektin teorik apo praktik, si dhe ndryshimet që ka pësuar legjislacioni penal, kanë diktuar nevojën e hartimit të një ligji të ri me qëllim rikonceptimin dhe forcimin e masave të kontrollit.

Realizimi i misionit dhe vizionit të sistemit të zbatimit të vendimeve penale me burgim, si pjesë e rëndësishme e sistemit të drejtësisë penale, mbështetet para së gjithash në integritetin, gatishmërinë, motivimin dhe kapacitetet profesionale të stafit.

Me gjithë ndryshimet e deritanishme, në praktikë dhe në raportet e vazhdueshme të organizatave të ndryshme (Departamenti Amerikan i Shtetit, Komiteti Shqiptar i Helsinkit,

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Avokati i Popullit etj.), janë hasur problematikat si më poshtë:

- Nuk janë përmirësuar kriteret e kualifikimit, zhvillimi i karrierës së punonjësve të policisë dhe promovimi në detyrë.
- Trajtimi ekonomik dhe financiar si dhe kushtet e punës kanë mbetur në nivele të ulëta në krahasim me agjencitë e tjera të përafërta në status dhe ecuri në karrierë.
- Trajnimi bazë dhe ndjekja e trajnimit të vazhdueshëm i punonjësve të policisë të rolit të mesëm, nuk është i përshtatshëm në lidhje me kërkesat për përmbushjen e detyrave.
- Kapacitetet profesionale dhe fizike, të disa shërbimeve, veçanërisht operacionale janë të ulëta dhe kanë nevojë për përtëritje. Përmirësimi i teknologjisë, kërkon një staf më të kualifikuar, me qëllim garantimin e sigurisë.
- Niveli i performancës së punonjësve të policisë së burgjeve është jo i kënaqshëm.
- Punonjësve nuk i sigurohet mbështetje pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.
- Punonjësve të Policisë së Burgjeve nuk i jepet apo garantohen të drejta strehimi i shprehur në forma të ndryshme si kompensimi i interesave të kredisë në një përqindje të caktuar.
- Punonjësve të policisë nuk i garantohet mbrojtje e veçantë kur i kërcënohet jeta, familja dhe prona për shkak të detyrës.
- Nuk realizohet kompensimi i orëve shtesë të punës të kryera gjatë pushimit javor, ose në ditët e festave zyrtare.

Shkaqet e këtyre problematikave janë si më poshtë:

- Menaxhimi i deritanishëm nuk garanton një balancë, ndërmjet kërkesave për përmirësimin e shërbimit publik dhe respektimit të të drejtave të punonjësve. Nga njëra anë punonjësit kanë detyrimin për të respektuar detyrimet ligjore lidhur me sigurinë në burgje në sajë të detyrimit për përmirësimin e shërbimit publik, ndërsa nga ana tjetër kushtet dhe mjetet që i janë vënë në dispozicion nuk janë sipas standarteve të nevojshme. Mungesa e trajtimit dhe kushteve sipas standarteve evropiane e bëjnë shumë të vështirë përmbushjen e detyrimeve dhe arritjen e objektivave të nëpunësve.
- Shpërndarja e 24 institucioneve të zbatimit të vendimeve penale, nga veriu në jug dhe në disa raste shumë larg qendrave urbane, me kapacitete të ndryshme, në të cilët trajtohen persona me rrezikshmëri të lartë për komunitetin dhe rendin publik sjell problematika të shumta në garantimin e sigurisë publike, sigurisë në burgje, të drejtave të personave në konflikt me ligjin dhe punonjësve. Shpërndarja e institucioneve të zbatimit të vendimeve penale shumë larg qendrave të banuara shkakton probleme infrastrukturore, lodhje fizike për punonjësit si dhe shtim të orarit të punës për shkak të akomodimit. Për më tepër shpërndarja e këtyre institucioneve duke marrë parasysh kapacitetin dhe mbipopullimin e burgjeve e bën të vështirë menaxhimin e situatave pavarësisht sistemimit referuar shkallës së rrezikshmërisë shoqërore. Si pasojë e mbipopullimit të institucionit dhe problematikave të hasura në institucion, punonjësit e kanë shumë të vështirë të ndërmarrin masat e kontrollit për të garantuar sigurinë në burgje. Referuar raporteve dhe studimeve të mësipërme është vërejtur se këto problematika janë të shtrira në 24 institucionet e zbatimit të vendimeve penale.
- Mbiipopullimi në burgje është një tjetër shkak dhe pse krahasuar me vitin 2016 është ulur ndjeshëm. Gjatë 2017, 2018 dhe fillimit të vitit 2019 mbiipopullimi është shënuar

si fenomen shqetësues në disa IEVP. Ky fenomen detyrimisht sjell pasoja në drejtim të reduktimit të kohës së ajrimit, kohës së takimit me të afërmit, të trajtimit individual të paraburgosurve nga ana e punonjësve të kujdesit social, ligjor etj. Mbipopullimi sjell pasoja edhe në drejtim të transferimit të dënuarve nga paraburgimet dhe komisaritet në institucione me pak të mbipopulluara larg vendbanimit të familjarëve të tyre. Ankesat referuar stafit të policisë së burgjeve dhe mbipopullimit janë të shumta.⁵

- Procedurat aktuale dhe situata në të cilën ndodhen punonjësit e policisë së burgjeve, ka sjellë vështirësi në rekrutimin e punonjësve cilësor dhe prezencën e një numri të konsiderueshëm të punonjësve me moshë mbi 55 vjeç, gjë që sjell vështirësi në kryerjen e detyrave që kanë lodhje fizike. Numri i punonjësve të policisë së burgjeve, mbi 50 vjeç është 24.7%.
 - Shkak tjetër i këtyre problematikave lidhet me kushtet e vështira të punës, trajtimin ekonomik dhe financiar, mungesën e mbështetjes pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës dhe mostrajnimi.
- **Grupet e prekura** nga ky problem janë punonjësit e insitucioneve të ekzekutimeve penale, të dënuarit apo të paraburgosurit, administrata shtetërore dhe qytetarët.

Trajtimi i problemit

Të gjitha këto probleme nuk mund të zgjidhen duke ndryshuar ligjin aktual, por është e domosdoshme hartimi i një projektligji të ri, i cili do të bëjë të mundur arritjen e objektivave.

Ligji i Policisë së Burgjeve, është miratuar fillimisht në Prill 1998. Në sajë të mosefektivitetit të këtij ligji, më datë 11.12.2008 është miratuar ligji nr. 10 032 i cili ka bërë rregullime të disa problematikave që ishin konstatuar, por gjithsesi problematikat vazhduan. Ligji nr. 10 032, datë 11.12.2008 iu nënshtua ndryshimeve në vitin 2014, në të janë të parashikuara të gjitha kriteret e kualifikimit, trajtimit ekonomik dhe financiar, trajnimit bazë dhe të vazhdueshëm. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve janë marrë të gjitha masat për programin dhe manualin e trajnimit të punonjësve. Pavarësisht këtyre parashikimeve ligjore dhe programeve të trajnimit të hartuara dhe të vëna në zbatim nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në mënyrë të vazhdueshme, vihet re që problematikat janë aktuale.

Sa më sipër, ndërhyrja e qeverisë vlerësohet e domosdoshme për rregullimin me ligj të këtyre problematikave, duke marrë parasysh edhe objektivat e Strategjisë së Reformës në Drejtësi dhe PKIE (Plani Kombëtar i Integritetit Europian). Ndryshimi i ligjit aktual nuk mund të arrijë objektivat e vendosura, duke qenë se duhet të ndryshohet më shumë se 70 përqind e ligjit aktual, pavarësisht se do të ketë më shumë kosto në burime dhe në kohë.

Stafi me uniformë, përbën $\frac{3}{4}$ e stafit të të gjithë burgjeve dhe kryen detyra të rëndësishme të sigurisë së brendshme të burgjeve si dhe gjatë shoqërimeve apo transferimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve gjatë kryerjes së veprimeve procedurale penale, transferimit nga një institucion në një institucion tjetër, për zhvillimin e seancave gjyqësore etj. Nevoja për forcimin e sigurisë në burgje dhe respektimin e të drejtave të njeriut, kërkon një mbështetje më të madhe të stafit me uniformë, duke përmirësuar procedurat e rekrutimit, trajnimit dhe vlerësimit të performacës.

Vitet e fundit është parë një dinamikë e madhe e personelit të policisë së burgjeve si rezultat i lirimeve nga detyra, gjë që ka rritur kostot financiare dhe ulur efektivitetin e trajnimeve.

⁵ <http://www.ahc.org.al/wp-content/uploads/2018/06/Raport-mbi-situaten-e-respektimit-te-te-drejtave-dhe-lirive-te-njeriut-ne-Shqiperi.pdf>

Hapja e institucioneve të reja dhe mungesat në organikë, kanë krijuar ngarkesa sasiore të punës në burgje, për shkak të rritjes së numrit të personave të dënuar dhe paraburgosur. Problemet e konstatuara kanë prekur, stafin, të dënuarit dhe mënyrën e menaxhimit të sigurisë.

Këto problematika nuk mund të rregullohen duke amenduar ligjin aktual, ndaj rekomandojmë që do të ishte e nevojshme hartimi i një Ligji të ri për policinë, i cili do të krijonte mundësi më të mëdha, për përmirësimin e shërbimeve dhe trajtimin e personelit, pavarësisht kostove në burime dhe kohë.

Arsyeja e ndërhyrjes

- Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.
- Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.
- Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.
- Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.
- Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.

Arsyet e ndërhyrjes së qeverisë dhe nevojshmëria

Ky projekt akt propozohet në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave, që parashikon se: *Qeveria do të hartojë dhe zbatojë një reformë rrënjësore në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimeve penale.* Pikërisht rishikimi i kriterëve hyrëse, ecuria në karrierë dhe përmirësimi i proceseve të punës së punonjësve të policisë së burgjeve, qëndrojnë në thelb të kësaj reforme. Për më tepër është e nevojshme ndërhyrja e qeverisë referuar të gjithë problematikave të konstatuara dhe objektivave që synohen të arrihen. Nga Drejtoria e Përgjithme e Burgjeve, Avokati i Popullit, Departamenti Amerikan i Shtetit, Komiteti Shqiptar i Helsinkit etj, në mënyrë të vazhdueshme është raportuar se siguria në burgje dhe trajtimi i punonjësve të policisë është në nivele shumë të ulëta dhe se duhen marra masa të menjëhershme.

Të drejtat dhe kushtet e punësimit të punonjësve të policisë së burgjeve janë të ulëta, sistemi i sigurisë në burgje nuk funksionon sipas standardeve evropiane për menaxhimin nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të stafit të policisë dhe përjasjen me standardet ndërkombëtare për menaxhimin e sigurisë në burgje dhe trajtimin e stafit policor.

Gjendja ekonomike financiare dhe kushteve të punës të punonjësve të Policisë së Burgjeve është më e ulët në raport të drejtë me punonjësit e agjencive të tjera të përafërta në status dhe ecuri në karrierë.

Procedurat e rekrutimit, trajnimit dhe promovimit në detyrë të punonjësve të policisë së burgjeve nuk janë fleksible për të përmirësuar statusin e punonjësve.

Nëpërmjet kësaj ndërhyrje synohet të trajtohet:

Nëpërmjet kësaj ndërhyrje do të trajtoheshin të gjitha problematikat që lidhen me sigurinë në institucionin e vuajtjes së dënimeve penale, trajtimin, garantimin e të drejtave, trajnimin dhe kushtet e punës të punonjësve.

Shkalla e ndërhyrjes së qeverisë

Për të zgjidhur problemin dhe për të arritur objektivat do të ishte e nevojshme hartimi i një projektligji të ri. Reflektimi i objektivave në ligjin aktual do të sillte një ndryshim në masën 70 përqind duke ndryshuar parimet themelore, parimet bazë dhe strukturën.

Objektivat e nivelit të lartë të qeverisë që mbështeten nga kjo ndërhyrje

Hartimi i këtij projektligji do të ishte në kuadër të angazhimit të qeverisë shqiptare për reformimin e sistemit të drejtësisë, ku sipas Programit të Qeverisë Shqiptare 2017-2021, pika 3.1 Shteti Ligjor dhe Drejtësia e Re, pjesë e rëndësishme e këtij reformimi do të jenë edhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Ky projekt akt propozohet në përputhje me

programin politik të Këshillit të Ministrave, që parashikon se: *Qeveria do të hartojë dhe zbatojë një reformë rrënjësore në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimeve penale.*

Punët ekzistuese që janë realizuar:

Ligji i Policisë së Burgjeve, është miratuar fillimisht në Prill 1998. Në sajë të mosefektivitetit të këtij ligji, më datë 11.12.2008 është miratuar ligji nr. 10 032 i cili ka bërë rregullime të disa problematikave që ishin konstatuar, por gjithsesi problematikat vazhduan. Ligji nr. 10 032, datë 11.12.2008 iu nënshtua ndryshimeve në vitin 2014, në të janë të parashikuara të gjitha kriteret e kualifikimit, trajtimit ekonomik dhe financiar, trajnimit bazë dhe të vazhdueshëm. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve janë marrë të gjitha masat për programin dhe manualin e trajnimit të punonjësve. Pavarësisht këtyre parashikimeve ligjore dhe programeve të trajnimit të hartuara dhe të vëna në zbatim nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në mënyrë të vazhdueshme, vihet re që problematikat janë aktuale.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit i mbetet qëndrimit se Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve (ShKB) si struktura që parandalon, zbulon apo dokumenton veprimtarinë kriminale të kryer nga punonjësit me ose pa uniformë në sistemin e Burgjeve, nevojitet të intensifikojë kontrollet dhe mbikëqyrjen, për të luftuar fuqimisht ndaj abuzimeve në sistemin e burgjeve. KShH rekomandon se ky organ duhet të tregojë më tepër objektivitet dhe paanshmëri.⁶

Sa më sipër, ndërhyrja e qeverisë vlerësohet e domosdoshme për rregullimin me ligj të këtyre problematikave, duke marrë parasysh edhe objektivat e Strategjisë së Reformës në Drejtësi dhe PKIE (Plani Kombëtar i Integritetit Europian).

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat kryesorë që synohen të arrihen janë:

- Të krijohet një staf me kapacitete të mjaftueshme profesionale duke i'u nënshtuar trajnimit bazë dhe të vazhdueshëm, i motivuar dhe me integritet, i aftë për të garantuar respektimin e masave të kontrollit, rendin dhe sigurinë në institucionet e ekzekutimeve penale dhe gjatë transferimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve.
- Të përmirësohet gjendja ekonomike financiare dhe kushteve të punës të punonjësve të policisë së burgjeve, në raport të drejtë me punonjësit e agjencive të tjera të përafërta në status dhe ecuri në karrierë për një afat tre vjeçar.
- Të përmirësohen procedurat e rekrutimit, trajnimit dhe promovimit në detyrë të punonjësve të policisë së burgjeve mbi bazën e procedurave transparente, të paanshme, shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit me qëllim përmirësimin e shërbimeve ndaj publikut për një afat tre vjeçar.
- Ti garantohet trajtim financiar pas ndërprerjes së marrëdhënies së ounës, në formën e pagesë kalimtare, pension të parakohshëm suplementar, pension shërbimi, pension suplementar pleqërie, vjetërsi në punë.
- Të kompensohen orët shtesë të punës së kryer gjatë pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare.
- Punonjësit të policisë ti garantohet mbrojtje e veçantë kur i kërcënohet jeta, familja dhe prona për shkak të detyrës.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*

⁶ <http://www.ahc.org.al/wp-content/uploads/2017/07/AHCAnnualReportPrint.pdf>.

- Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.
- Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.

Opsioni 0 – *status quo*-ja

Nëse nuk ndërmerret kjo nismë dhe qëndrojmë te akti ligjor ekzistues që është Ligji Nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”, problematikat e konstatuara gjatë viteve në shërbimin e policisë, do të mbeten prezente, duke sjellë probleme të sigurisë, të demotivimit të punonjësve, dinamikë të madhe të lirimeve nga puna, që shoqërohet edhe me nje kosto financiare dhe paqëndrueshmëri të shërbimit.

Nxjerrja e një ligji të ri apo ndryshimi i ligjit ekzistues mund të mos kërkohet me arsyetimin se çështja mund të vetë rregullohet apo rezultatet mund të arrihen me mënyra të tjera jo formale, por për të plotësuar objektivat që synohen të arrihen është e domosdoshme të miratohet një ligj i ri pavarësisht kostove në burime dhe në kohë.

Opsioni 1- Ndryshimi Ligji Nr.10032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”

Ndryshimi i ligjit Nr.10032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve” do të kishte më pak kosto në burime dhe në kohë, por do të ulte sigurinë e zbatimit të ligjit dhe mund të krijojë dyshime mbi stabilitetin e ligjit dhe të lëkundë besimin në të.

Për të zbatuar objektivat që synohen të arrihen është e nevojshme të ndryshohen parimet kryesore të ligjit ekzistues, parimet bazë dhe struktura e tij, ndryshime të cilat arrijnë masën 70 përqind. Këto ndryshime prekin thelbin e ligjit dhe nuk rregullojnë disa aspekte të tij, ndaj duhet të mendohet mbi mundësinë e hartimit të një ligji të ri.

Në rast se do të vije me amendime në ligjin ekzistues, nuk do të arrihej objektivi kryesor për përmirësimin e kushteve të trajtimit financiar të punonjësve, kushteve të punës, trajnimet dhe për përcaktimin e procedurave të promovimit dhe zhvillimit të karrerës.

Opsioni 2 (i preferuar) – Miratimi i një ligji të ri për “Policinë e Burgjeve” si bazë ligjore për përmirësimin e veprimtarisë së institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, sigurinë në to dhe grantimin e të drejtave të punonjësve duke garantuar stabilitet ligjor.

Miratimi i këtij ligji nuk ka një kosto të lartë në buxhetin e shtetit, krahasuar me përfitimet në sigurinë publike, në qëndrueshmërinë e shërbimit, në krijimin e një stafi të trajnuar, me eksperiencë dhe të motivuar për përmbushjen e detyrave.

Ky projekt akt duhet të propozohet si rezultat i problematikave të shumta të kontatuara nga organizma të ndryshëm dhe në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave, që parashikon se: *Qeveria do të hartojë dhe zbatojë një reformë rrënjësore në sistemin e institucioneve të vuajtjes së dënimeve penale.* Krahas rezultateve pozitive, në garantimin e sigurisë dhe rehabilitimin e personave në konflikt me ligjin, që ka arritur sistemi shqiptar i burgjeve dhe paraburgimeve nga ligji Nr.10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar, vlerësohet se ka disa problematika të cilat duhen përmirësuar duke marrë parasysh edhe objektivat e Strategjisë së Reformës në Drejtësi dhe PKIE (Plani Kombëtar i Integritetit Europian) të cilat nuk mund të arrihen duke ndryshuar ligjin aktual. Miratimi i një ligji të ri është opsioni i preferuar pavarësisht se do të do të ndikojë në ekonomi si kosto në buxhetin e shtetit, por është e domosdoshme për të arritur objektivat duke llogaritur përfitimet në buxhetin e shtetit apo ndikimet sociale.

Nëse bëjmë një raport mes kostove në buxhetin e shtetit dhe të drejtave të punonjësve, dënuarve, paraburgosurve, qytetarëve dhe në tërësi interesit publik vihet re që përfitimet janë më të mëdha pasi do të kishim: Një staf me kapacitete të mjaftueshme profesionale të aftë për të garantuar rendin dhe sigurinë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, përmirësim të gjendjes ekonomike-financiare dhe kushteve të punës të punonjësve të policisë së burgjeve, përmirësim të procedurave të rekrutimit, trajnimit dhe promovimit në detyrë,

rotacion brenda sistemit, garantim të të drejtave të punonjësve duke i'u siguruar mbështetje sociale edhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, kompensim të orëve shtesë të punës së kryer gjatë pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare, mbrojtje të veçantë etj.

-Opsionet e rëndituara janë zgjedhur referuar avantazheve dhe disavantazheve të secilit prej opsioneve, për të zgjedhur në fund opsionin më të mirë. Referuar avantazheve dhe disavantazheve të opsioneve, konstatojmë se opsioni më i mirë për të zgjidhur problematikat dhe për të arritur objektivat është opsioni i dytë. Më poshtë është pasqyruar në mënyrë të detajuar vlerësimi i opsionit të preferuar dhe ndikimi që ka tek subjektet që preken nga kjo iniciative.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto tëndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Për sa i përket analizës së Opsionit 1 dhe Opsionit 2, sqarojmë se grupet e prekura dhe ndikimet ekonomike dhe pjesërisht ndikimet sociale janë të njëjta për të dyja opsionet të cilat mund ti gjeni si më poshtë vijon:

Miratimi i ligjit të ri për policinë e burgjeve, do të ketë impakt pozitiv tek të dënuarit dhe paraburgosurit, të cilët do të kenë një shërbim më të mirë, tek publiku, vizitorët, shoqëria në tërësi dhe tek punonjësit që përfitojnë drejtpërdrejt.

Me miratimin e ligjit do të zgjidhen dhe përcaktohen qartë disa kompetenca dhe përgjegjësi të menaxherëve dhe punonjësve supervizues/mbikqyrës.

Në vijim janë identifikuar në mënyrë më të hollësishme target-grupet kryesore që preken nga kjo politikë.

- **Punonjësit e Policisë së Burgjeve**

Ky projektligj do të sjellë një impakt shumë pozitiv te punonjësit duke qenë se do të kenë një trajtim më të mirë financiar dhe në kushtet e punës, do të pajisen me uniforma dhe mjete

të reja dhe do t'u paguhen orët shtesë të kryera në ditët e pushimit dhe festave zyrtare. Stafi do të ketë kapacitete të mjaftueshme profesionale duke qenë se do të përmirësohen procedurat e rekrutimit. Në këtë mënyrë ato do t'i nënshtrohen trajnimit bazë dhe do të ndjekin trajnimin e vazhduar me qëllim pasjen e një stafi të trajnuar, me eksperiencë dhe të motivuar. Punonjësve të policisë do ti sigurohet mbështetje pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe mbrojtje e veçantë. Nga arritja e këtyre objektivave do të kishim 3550 punonjës të institucioneve të ekzekutimeve penale të kënaqur jo vetëm nga ana ekonomike, por dhe ajo profesionale.

- Të dënuarit apo paraburgosurit

Të dënuarit dhe të paraburgosurit janë një tjetër target grup që përfitojnë nga ndryshimi i politikës duke qenë se nëse realizohen objektivat e vendosura do të rritet siguria dhe mirëqenia e tyre në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Një staf i kualifikuar, trajnuar dhe motivuar do t'i ndihmonte në rehabilitimin më të shpejtë të tyre që është një nga synimet e dënimit. Mënyra e trajtimit të këtyre personave nga një staf i kualifikuar do të garantonte të drejtat e tyre duke qenë se do të përmirësoheshin standartet dhe struktura mbështetëse. KShH sugjeron që drejtuesit e DPB dhe të institucioneve vendore penale të synojnë drejt krijimit të një klime të mirë dhe të sigurt, ku si shtetasit e paraburgosur dhe ata të dënuar nga njëra anë dhe personeli nga ana tjetër, duhet të bashkëjetojnë dhe bashkëpunojnë në kushtet ku të gjithë të ndihen të sigurt. Kjo është baza e një funksionimi të mirë të institucionit që parandalon situata dhe incidente të rënda. Komunikimi i mirë dhe profesional mes personelit dhe të burgosurve dhe siguria dinamike përbëjnë bazën e klimës së sigurt në një institution.

- Vizitorët

Ndërmarrja e këtyre politikave do të kishte një impakt shumë pozitiv tek vizitorët të cilët në momentin që futen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale do të trajtoheshin me respekt dhe profesionalizëm nga punonjës të kualifikuar. Për më tepër duke e lidhur me ndikimin që ka tek të dënuarit dhe paraburgosurit imapkti që të krijohej do të ishte a i një institucioni të ekzekutimit të dënimit fleksibël i cili ka ndikuar në rehabilitimin e shpejtë të personave. Vizitorëve do t'iu garantohej siguri dhe shërbim i qëndrueshëm.

- Shoqëria në tërësi

Shoqëria është një nga grupet e prekura nga ndërmarrja e kësaj politike. Ndikimi më i rëndësishëm është ai i rritjes së sigurisë publike, që vjen nga rritja e sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Për më tepër rehabilitimi i personave në konflikt me ligjin

Ndikimet ekonomike:

Kosto në buxhetin e shtetit: Fondet e nevojshme për përmirësimin e pagesave të stafit të policisë së burgjeve, për arsye të rrezikshmërisë, vështirësisë dhe rëndësisë së shërbimit, mbështetje për lehtësimin e transportit të punonjësve të cilët punojnë në IEVP, larg qendrave urbane. Përmirësim i teknologjisë në tërësi dhe pajisjeve të policisë së burgjeve. Trajtimi i familjarëve të punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës. Trajtimi financiar pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Mbrojtja e veçantë që i sigurohet për shkak të detyrës. Kompensimi i orëve shtesë. Trajnimi bazë dhe i vazhdueshëm.

Aktualisht numri total i punonjesve të policisë së burgjeve është 3550, nga të cilët 230 janë punonjës të rolit të mesëm.

Nuk ka kosto për transportin e punonjësve, me Urdhër të Ministrit parashikohet një distancë jo më shumë se 45 Km. Uniforma e një punonjesi, të rolit të mesëm kushton 65000 lekë x 230 punonjës = 14.950.000 lekë. Uniforma e një punonjesi të rolit bazë kushton 60000 lekë x

3220 punonjës =193.200.000. Totali i kostove vetëm për uniforma shkon në 223.100.000 lekë.

Kostoja e trajnimit bazë për një punonjës është 780 lekë/ditë, kjo sipas shpenzimit të kryer për trajtimin me ushqim ditor, në ambjentet e akademisë së policisë, pjesa tjetër është si akomodimi, etj janë mbuluar tek institucioni i akademisë së policisë së shtetit. Në total kosto trajnimi, llogariten rreth 15.000.000 lekë (catering, mjete mësimore, udhëtime, dieta etj)

Me hartimin e një projektligji të ri kosto në tërësi do të ishte më e lartë nga ana ekonomike, por në raport me përfitimet që do të sjellë është më e ulët. Ky projektigj do të kishte një ndikim pozitiv tek punonjësit, të dënuarit, paraburgosurit, vizitorët, administratën dhe shoqërinë në tërësi.

Përfitimet e drejtpërdrejta ekonomike në buxhetin e shtetit: Ulje të numrit të punonjësve që lirohen dhe përfitojnë pagë kalimtare. Reduktim të shpenzimeve në përdorimin e pajisjeve, uniformave dhe mjeteve të tjera. Ulje të kostos së trajnimeve.

Përfitimi jo i drejtpërdrejtë ekonomik: Përtej efekteve ekonomike, propozimi për hartimin e një projektligji për Policinë e Burgjeve do të ndikonte në:

- Krijimin e një stafi të kualifikuar, të motivuar dhe të përgjegjshëm të cilët do të kishin aftësinë të garantonin sigurinë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.
- Do të garantohej siguria publike dhe rehabilitimi i personave në konflikt me ligjin.
- Ulje të shpenzimeve për sa i përket mbështetjes shëndetësore dhe psikologjike që duhet ti garantohet personave në konflikt me ligjin si rrjedhojë e dhunës së ushtruar nga punonjësit e policisë.

Ndikimet sociale:

Propozimi pritet të sjellë:

- Ulje të lirimeve nga puna dhe motivim të punonjësve;
- Rritje të standarteve të shërbimit ndaj personave në konflikt me ligjin;
- Përmirësim i procesit të rehabilitimit dhe riintegrit të të dënuarve dhe paraburgosurve në shoqëri;⁷
- Rritje e ndërgjegjësimit të shoqërisë për rolin e policisë së burgjeve, vështirësitë në kryerjen e detyrës dhe të sigurisë publike;
- Mbështetje më të mirë sociale për familjet e punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës dhe mbrojtje të veçantë fizike në raste rreziku apo situatë emergjente;
- Rritje të besimit ndaj sistemit qeverisës për shkak të përmirësimit të trajtimit ekonomik dhe financiar, kushteve të punës, mbështetjes, trajnimeve dhe gatishmëri më e lartë ndaj detyrave.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Opsioni i rekomanduar/i preferuar është:

Opsioni 2.

Avantazhet e opsionit të zgjedhur për përfituesit e drejtpërdrejtë

- Pritet një përmirësim i dukshëm në sigurinë e burgjeve dhe paraburgimeve. Punonjësit do të duhet t'i nënshtrohen një programi të trajnimit bazë dhe të ndjekin programin e trajnimit të vazhduar.

⁷ <https://www.osce.org/sq/albania/246866>

- Miratimi i këtij ligji nuk ka një kosto të lartë në buxhetin e shtetit, krahasuar me përfitimet në sigurinë publike, në qëndrueshmërinë e shërbimit, në krijimin e një stafi të trajnuar, me eksperiencë dhe të motivuar për përmbushjen e detyrave.
- Do të balancohet më mirë interesi publik, për siguri duke qenë se do të përmirësohen standartet lidhur me sigurinë në burgje dhe respektimi i të drejtave të punonjësve.
- Krijimin e një stafi me kapacitete të mjaftueshme profesionale, të motivuar dhe me integritet, të aftë për të garantuar sigurinë në burgje dhe paraburgime.
- Përmirësimin e gjendjes ekonomike financiare dhe kushteve të punës të punonjësve të Policisë së Burgjeve, në raport të drejtë me punonjësit e agjencive të tjera të përafërta në status dhe ecuri në karrierë.
- Miratimi i një ligji të ri do të sjellë impakt pozitiv lidhur me kënaqësinë në punë të punonjësve të policisë duke qenë se do kenë një trajtim financiar më të mirë, do të pajisen me uniforma dhe mjetë që do ti shërbejnë në realizimin e detyrave dhe për rrjedhim një shërbim më të mirë ndaj publikut, siguri dhe shërbim të qëndrueshëm.
- Pajisje më e mirë e punonjësve të policisë së burgjeve me uniforma, mjete, mbështetje me transport etj. Do të përmirësohen strukturat mbështetëse që shërbejnë për sigurinë në institucionet e vuajtjes së dënimit
- Zhvillim karriere dhe promovim në detyrë bazuar në kriteret e qarta të performancës.
- Përmirësimin e procedurave të rekrutimit, trajnimit dhe promovimit në detyrë të punonjësve të policisë së burgjeve.
- Garantimin e rotacionit të vazhduar brenda sistemit, me qëllim motivimin dhe shmangien e konsumit profesional, të stresit dhe frustrimit të punonjësve.
- Respektimin e të drejtave të punonjësve duke siguruar mbështetje edhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.
- Mbrojtja e veçantë.

Për përfituesit jo të drejtpërdrejtë miratimi i një ligji të ri do të sjellë:

- Rritje të sigurisë publike.
- Rehabilitim të personave të dënuar dhe përmirësim e mënyrës së trajtimit të personave që ndodhen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve.

Përfitimet sociale mbi grupet e prekura do të jenë më të mëdha për arsyet se do të garantohen:

- Rritje të besimit ndaj sistemit qeverisës për shkak të përmirësimit të trajtimit ekonomik dhe financiar, kushteve të punës, mbështetjes, trajnimeve dhe gatishmëri më e lartë ndaj detyrave;
- Shërbime ndaj personave në konflikt me ligjin, me standarte më të larta;
- Ulje të lirimeve nga puna dhe motivim të punonjësve;
- Rehabilitimi dhe riintegrimi i personave në shoqëri;
- Rritja e ndërgjegjësimit së shoqërisë për rolin e policisë së burgjeve, vështirësitë në kryerjen e detyrës dhe të sigurisë publike;
- Mbështetje më të mirë sociale për familjet e punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës, mbrojtje të veçantë fizike në raste rreziku apo situatë emergjente;
- Përmirësim të efekteve psikologjike tek të dënuarit/paraburgosurit, punonjësit dhe familjarët.

Aktualisht numri total i punonjesve të policisë së burgjeve është 3550, nga të cilët 230 janë punonjës të rolit të mesëm. Buxheti për transportin e policisë së burgjeve, nuk llogaritet, pasi me Urdhër parashikohet një distancë jo më shumë se 45 Km.

Uniforma e një punonjësi, të rolit të mesëm kushton 65000 lekë X 230 punonjës =14.950.000 lekë. Uniforma e një punonjësi të rolit bazë kushton 60 000 lekë x 3220 punonjës = 193.200.000 lekë. Totali i kostove vetëm për uniforma është 223.100.000 lekë.

Buxheti për pagën referuar VKM-së Nr. 201, datë 15.03.2017 është 3.041.793.576 lekë.

Kosto trajnimi, llogariten rreth 15.000.000 lekë (catering. mjete mesimore, udhetime dieta etj).

Me hartimin e një projektligji të ri kosto në tërësi do të ishte më e lartë nga ana ekonomike, por në raport me përfitimet që do të sjellë është më e ulët. Ky projektigj do të kishte një ndikim pozitiv tek punonjësit, të dënuarit, paraburgosurit, vizitorët, administratën dhe shoqërinë në tërësi.

Ndërsa me projektligjin që propozohet vlera monetare e koston dhe e përfitimeve nga ndikimet e mundshme është përcaktuar duke iu referuar shtesave në pagë të punonjësve të sigurisë, për ti unifikuar me punonjës të policisë së shtetit, për të njëjtin nivel. Mbështetje për transportin e punonjesve dhe për ushqim. Punonjësi i Policisë së Burgjeve, duhet të ketë përparësi në trajtimin financiar, ku duhet të parashikohet të përfshihet kompensimi për privacionet që i krijohen punonjësit të policisë së burgjeve për largësi nga vendbanimi, sipas koston së transportit publik dhe trajtimit për ushqim. Trajtimi financiar pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës, mbrojtja e veçantë, trajnimet, kompensimi i orëve shtesë të kryera në ditët e pushimit dhe gjatë ditëve të festave zyrtare dhe kompensimi i një përqindje të caktuar

	2019	2020	2021
	1,006,987	1,006,987	1,006,987

të vlerës së kredisë për strehim janë disa nga kostot që do të rëndojnë mbi buxhetin e shtetit.

Në tabelën e më poshtme janë llogaritur nevojat për buxhet gjatë viteve.

Miratimi i një ligji të ri, bëhet edhe për të shmangur ndërhyrjet e shpeshta në ligjin eksistues si dhe duke qënë se ndryshimet e propozuara prekin më shumë se 70% të ligjit ekzistues.

Analiza me shumë kriterë

Opsionet që merren në konsideratë janë:

Opsioni 0 – status quo-ja

Opsioni 1- Ndryshimi Ligji Nr.10032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”

Opsioni 2 (i preferuar) – Miratimi i një ligji të ri për “Policinë e Burgjeve”

Kriteret për vlerësimin e opsioneve dhe pesha e secilit sipas rëndësisë relative

- Potenciali për të krijuar një staf me kapacitete të mjaftueshme profesionale, të motivuar dhe me integritet, të aftë për të garantuar respektimin e masave të kontrollit, rendin dhe sigurinë në institucionet e ekzekutimeve penale dhe gjatë transferimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve. **2**
- Potenciali për të përmirësuar gjendjen ekonomike financiare dhe kushteve të punës të punonjësve të policisë së burgjeve. **4**
- Potenciali për të përmirësuar procedurat e rekrutimit, trajnimit dhe promovimit në detyrë të punonjësve të policisë. **2**
- Potenciali për të bërë rotacion brenda sistemit me qëllim motivimin dhe shmangien e konsumit profesional, të stresit dhe frustrimit të punonjësve. **2**
- Potenciali për ti siguruar punonjësve mbështetje sociale edhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës. **3**
- Potenciali për ti ofruar punonjësve mbështetje për tu strehuar mbi bazën e kompensimit të një përqindjeje të caktuar të interesit të kredisë dhe në transport. **3**
- Potenciali për të kompensuar orët shtesë të punës së kryer gjatë pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare. **4**

- Potenciali për ti garantuar punonjësit të policisë mbrojtje të veçantë kur i kërcënohet jeta, familja dhe prona për shkak të detyrës. **4**

O Shkalla e performancës është nga 0 në 5, ku zero indikon se opsioni nuk e plotëson aspak kriterin dhe 5 indikon se opsioni e plotëson tërësisht kriterin e përcaktuar.

Kriteret	Pesha	Opsioni 0	Vlera Opsioni 1 =Pesha *Pike	Opsioni 1	Vlera =Pesha *Pike	Opsioni 2	Vlera =Pesha *Pike
Potenciali për të krijuar një staf me kapacitete të mjaftueshme profesionale, të motivuar dhe me integritet, të aftë për të garantuar respektimin e masave të kontrollit, rendin dhe sigurinë në institucionet e ekzekutimeve penale dhe gjatë transferimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve.	2	0	0	3	6	4	8
Potenciali për të përmirësuar gjendjen ekonomike financiare dhe kushteve të punës të punonjësve të policisë së burgjeve.	4	0	0	3	12	4	16
Potenciali për të përmirësuar procedurat e rekrutimit, trajnimit dhe promovimit në detyrë të punonjësve të policisë.	2	1	2	3	3	4	8
Potenciali për të bërë rotacion brenda sistemit me qëllim motivimin dhe shmangien e konsumit profesional, të stresit dhe frustrimit të punonjësve.	2	1	2	2	4	4	8
Potenciali për ti siguruar punonjësve mbështetje sociale edhe pas ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.	3	0	0	0	0	4	12
Potenciali për ti ofruar punonjësve mbështetje për tu strehuar mbi bazën e kompensimit të një përqindjeje të caktuar të interesit të kredisë dhe në transport.	3	0	0	0	0	4	12
Potenciali për të kompensuar orët shtesë të punës së kryer gjatë pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare.	4	1	4	3	12	5	20

Potenciali për ti garantuar punonjësit të policisë mbrojtje të veçantë kur i kërcënohet jeta, familja dhe prona për shkak të detyrës.	4	0	0	2	8	4	16
Pikët ne total			8		45		100

Referuar analizës me shumë kritere opsioni i preferuar është opsioni 2 duke qenë se plotëson në shkallë më të lartë kriterin e përcaktuar. Ndaj është e nevojshme miratimi i një ligji të ri për policinë e burgjeve në mënyrë që të arrihen objektivat.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Opsioni i zgjedhur (i preferuar) do të zbatohet nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit pas botimit në Fletoren Zyrtare. Për zbatimin e opsionit të prferuar të ngarkohet Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Hartimi i akteve nënligjore do të bëjnë të mundur zbatimin e ligjit dhe arritjen e objektivave të synuara. Ministria e Drejtësisë nëpërmjet strukturës së saj përkatëse të dedikuar monitorimit të institucioneve të varësisë, ku përfshihet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve do të realizojnë mënyrën e zbatimit të kësaj politike në nivel makro.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Pas hyrjes në fuqi të ligjit, Këshilli i Ministrave dhe Ministri e Drejtësisë ngarkohen që të miratojnë aktet nënligjore përkatëse. Monitorimi dhe vlerësimi i i performancës së policisë së burgjeve do të realizohet në bazë të një plani vjetor të planifikuar të inspektimit nga struktura përkatëse pranë Ministrisë së Drejtësisë. E njëjta metodologji pune do të ndiqet edhe nga Drejtoria e Përgjithshme. Në bazë të planit vjetor secili prej punonjësve do të monitorohet dhe vlerësohet nga inspektorët në lidhje me performancën në punë dhe do ti krijohet një plan pune i pavarur për tu përshtatur me objektivat që synohet të arrihen.

Monitorimi në nivel makro do të realizohet nga struktura përkatëse përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë, për monitorimin e institucioneve të varësisë. Gjithashtu nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve do të realizohet monitorimi i zbatimit të detyrave në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore nga ana e punonjësve të degëve territoriale.

Avokati Popullit dhe sindikata e pavarur e punonjesve, do të jenë pjesë e inspektimit të zbatimit të të drejtave të punonjësve, por që kanë pasoja mbi personat që janë në konflikt me ligjin. Punonjësi i Policisë së Burgjeve mban përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e çdo veprimi apo mosveprimi të tij, gjatë ushtrimit të detyrës. Në rastet kur urdhri është i paligjshëm ai nuk duhet ta zbatojë, ndërsa kur urdhri, që konsiderohet i paligjshëm nga urdhërmarrësi, ka të bëjë me trajtimin dhe të drejtat themelore të personave të dënuar me burgim dhe të paraburgosur, punonjësit e Policisë së Burgjeve, që kanë dijeni për të, kanë detyrimin të njoftojnë krahas strukturave të Ministrisë së Drejtësisë, edhe Avokatin e Popullit. Avokati i Popullit si pjesë e inspektimit dhe mbrojtjes së të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të

administratës publike do të monitorojë këto njoftime që kanë pasoja të drejtpërdrejta në të drejtat e personave në konflikt me ligjin.

Treguesit e monitorimit përfshijnë një sërë treguesish, që përfshijnë të dhëna numrin e incidenteve, mungesave në punë, shkeljeve disiplinore, ngjarje të rënda lidhur me sigurinë etj.

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

Raporti i ndikimit të vlerësimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – njëherë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – njëherë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – njëherë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										
Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – njëherë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e kostos në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) =Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsiioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionëlekë		Vlera aktuale neto në milionëlekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			